



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1102/ 3 Prot.

Tiranë, më 01. 10. 2018

V E N D I M

Nr. 188, Datë 01. 10. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 114, datë 03.08.2018, e shtetasit M. B., kundër Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike “Isuf Gjata”, Korçë (në vijim Shkolla “Isuf Gjata”), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të racës dhe gjendjes ekonomike.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi ndjek vitin e 3-të të arsimit të mesëm profesional në Shkollën “Isuf Gjata”, Korçë, në degën Hoteleri-Turizëm. Mbështetur në VKM-në Nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018”, ankuesi ka përfituar këstin e parë të bursës, si nxënës që vjen nga familje me vështirësi ekonomike dhe komunitet egjiptian. Në muajin Korrik 2018, është vënë në dijeni nga ana e sekretarisë së shkollës, se për shkak të mosfrekuentimit të mësimin nuk mund të përfitojë këstin e dytë të bursës.

Në këto kushte, ankuesi ndjehet i trajtuar në mënyrë pabarabartë dhe diskriminuese nga ana e Shkollës “Isuf Gjata”, Korçë, duke i mohuar të drejtën e përfitimit të këstit të dytë të bursës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr. 1102 prot., datë 09.08.2018 është njoftuar Drejtoria e Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike “Isuf Gjata”, Korçë dhe i është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Në përgjigje² të shkresës së sipërcituar, Shkolla “Isuf Gjata”, ndër të tjera sqaroi se: “...Nxënësi ka marrë këstin e parë sipas të gjitha procedurave, ndërsa përsa i përket këstit të dytë, nxënësi nuk e përfitoi pasi u largua nga shkolla dhe nuk frekuentoi që në 22 Janar 2018. Po kështu, ju bëjmë me dije se në bazë të dokumentacionit të shkollës (rregjistër klase), nxënësi në fjalë nuk ka pasur frekuentim të rregullt edhe për periudhën për të cilën ai ka përfitur këstin e parë. Pra, nxënësi

¹ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

² Me anë të shkresës Nr. 134 prot., datë 14.08.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1102/1 prot., datë 16.08.2018

nuk frekuentoi shkollën dhe për këtë arsye nxënësit i ndërpritet bursa, jo nga shkolla por nga pushteti vendor, i cili ka kompetencën e ekzekutimit të VKM-së për bursat.”

2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri, me anë të e-mailit, kontaktoi³ me Shkollën “Isuf Gjata”, për të marrë informacion dhe prova shtesë, lidhur me frekuentimin e mësimit nga ana e ankuesit për periudhën që është sqaruar në shkresën Nr. 134 prot., datë 14.08.2018 të shkollës.

Në vijim më datë 25.09.2018, Shkolla “Isuf Gjata”, vuri në dispozicion të KMD⁴-së:

- *Kopje të regjistrit të klasës, në të cilën mëson nxënësi M. B., ku evidentohet largimi i tij nga shkolla për arsye emigrimi më datë 22.01.2018.*
- *Kopje të shkresës së dërguar pushtetit vendor me informacion për nxënësit që perfitojnë bursë, në të cilën evidentohet se ankuesi është larguar nga shkolla.*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, gjatë vitit shkollor 2017-2018, ankuesi ka qënë i rregjistruar në klasën e 12-të të Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike “Isuf Gjata”, Korçë, në degën Hoteleri-Turizëm. Mbështetur në VKM-në Nr. 753, datë 13.12.2017 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018”* dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë Nr. 35, datë 30.03.2018, ka përfituar këstin e parë të bursës, si nxënës që vjen nga familje me vështirësi ekonomike dhe komunitet egjiptian.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, arsimit dhe edukimit të fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë apo nga komuniteti rom/egjiptian etj. Vazhdimisht në legjislacionin shqiptar janë parashikuar mekanizma për të stimuluar arsimimin dhe edukimit,

³ Kërkesë me e-mail dt. 16.08.2018 dhe dt. 25.09.2018, drejtuar Shkollës “Isuf Gjata”, në adresën shk_isufgjata@yahoo.com

⁴ Shkurtesë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

nëpërmjet dhënies së bursave dhe programeve të tjera mbështetëse për fëmijët që vijnë nga komuniteti rom/egjiptian, që ndjekin arsimin profesional.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 753, datë 13.12.2017 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017-2018”*, në pikën 2.3, germa dh), ka parashikuar se përfitojnë bursë të plotë: *“Nxënësit të komunitetit rom dhe egjiptian që rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional”*.

Mbështetur në pikën 4.1 të VKM-së Nr. 753, datë 13.12.2017, ku parashikohet se: *“Drejtorët e shkollave profesionale, për nxënësit që regjistrohen dhe ndjekin studimet me kohë të plotë në vitin e parë shkollor 2017-2018, sipas pikës 2.4, të këtij vendimi, u dërgojnë informacion njësisive bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 20 dhjetor 2017.”*, drejtoria e Shkollës “Isuf Gjata”, ka vënë në dispozicion të Bashkisë Korçë, listën e nxënësve që përfitojnë bursë për vitin shkollor 2017-2018.

Në këto kushte dhe mbështetur në parashikimin e pikës 5 të VKM-së së sipërcituar, ku citohet se: *“Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve nga shtresat, kategoritë sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë.”*, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë, me Vendim Nr. 35, datë 30.03.2018, ka miratuar si përfitues të renditur të 59-in në listë edhe nxënësin M. B.

Sipas informacionit⁵ të administruar nga ana e Shkollës “Isuf Gjata”, nxënësi M. B. më datë 22.01.2018, është larguar nga shkolla për arsye emigrimi. Në këto kushte dhe mbështetur në parashikimet e pikës 12 dhe 13 të VKM-së Nr. 753, datë 13.12.2017, ku përcaktohet se: *“12. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore realizojnë pagesën e bursës për nxënësit përfitues, vetëm pasi drejtorët e shkollave profesionale konfirmojnë, zyrtarisht, brenda datës 5 të çdo muaji, pranë njësisive të qeverisjes vendore, informacionin për ndjekjen/frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë. 13. Nxënësve që nuk frekuentojnë mësimin apo nuk ndjekin praktikën profesionale pa arsye ligjore apo shëndetësore u ndërpritet menjëherë bursa”*, drejtoria e Shkollës “Isuf Gjata”, ka dërguar pranë Bashkisë Korçë, listën emërore të nxënësve që përfitojnë bursën dhe atyre që për shkak të mosfrekuentimit të mësimin duhen përjashtuar nga ky përfitim. Në shkresën e përcjellë, ankuesi rezulton i larguar nga shkolla dhe rrjedhimisht nuk përfiton këstin e mbetur të bursës.

⁵ Kopje e rregjistrimit të Klasës ku mëson nxënësi M. B., ku është me numër rendor 18.

Përsa më lart dhe mbështetur në informacionin e administruar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se drejtorja e Shkollës “Isuf Gjata”, Korçë, nuk ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm krahasuar me nxënës tjerë. Pra, konstatohet se është ndjekur e njëjta procedurë për përjashtimin nga përfitimi i bursës, për të gjithë nxënësit, që për arsye të ndryshme nuk kanë frekuentuar mësimin.

Në përfundim, refruar provave të administruara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk konstaton të jenë kryer veprime apo sjellje diskriminuese ndaj shtetasit M. B., nga ana e drejtuesve të Shkollës “Isuf Gjata”, Korçë, për shkak të përkatësisë në komunitetin egjiptian apo gjendjes ekonomike të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit M. B., nga ana e Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike “Isuf Gjata”, Korçë, për shkak të racës apo gjendjes ekonomike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Racë dhe gjendje ekonomike)

(Fusha: Arsim)